



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE "NAZMI RUSHITI" PESHKOPI
Adresa: Lagjia "Nazmi Rushiti" Sheshi "Demokracia" tel. 021822348E-mail: nrprofesionale@yahoo.com

NJOFTIM

Peshkopi më: 06.01.2023

Nr. 61 prot

Lënda: Njoftim për vend të lire pune

Drejtuar: DREJTORISË SË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të Ligjit nr.15 /2019, "Për nxitjen e punësimit ; të ligjit nr.15 / 2017 " Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë ", të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.554 datë 31.07.2019 " Për Krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive", të Udhëzimit nr. 14, datë 27.5.2021 " Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit"

Ofruesi publik i AFP - së - shkolla e mesme profesionale " Nazmi Rushiti " Peshkopi, ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin – Nëndrejtor i kulturës profesionale

1 – Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme për nëndrejtorin

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithdhme për lëvizjen paralele si vijon :

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të organizimit dhe planifikimit strategjik, aftësi analitike për zgjidhjen e problemeve;
- g) të demonstrojë aftësi drejtuese, të punës në grup dhe motivimit.

2. Kriteret e posaçme, që mbulon kulturën profesionale:

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme për lëvizjen paralele si vijon :

- a) të ketë diplomë të studimeve universitare të nivelit "Master shkencor" (ose të barasvlerëshme) në një nga fushat që lidhet me kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së;
 - b) të ketë të paktën kategorinë "Mësues I kualifikuar";
 - c) të ketë punuar të paktën 5 vjet në një ofrues publik të AFP-së;
 - d) të ketë njohuri të certifikuara në përdorimin e teknologjisë së informacionit.
4. Të ketë përvojë pune të paktën 3 vjet në fushën që lidhet me kualifikimet profesionale profesionale të njërit prej drejtimeve mësimore të ofruesit të AFP - së

2. Dosja e aplikimit, e cila përmban

Dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) letërmotivimin për pozicionin;
- b) jetëshkrimin (CV-në),
- c) kartën e identitetit;
- d) diplomën;
- e) librezën e punës;
- f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- g) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- i) vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- j) vërtetim nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
- k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre.

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në e protokollit të ofruesit publik të AFP-së,
brenda datës 16 . 01 . 2023.

DREJTORI

Alma SELAMI

